REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. 09
Org.Jedinica
Org Unit
Nr.Prot: 05-7789
Broj Prot:
Prot.No:
Nr.i faqeve -5-
Br.stranica
No.pages
Data: 08/10/2024
Datum:
Date:
Prishtinë / a

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizije nabavke/Procurment Division

KONTRATË

"Furnizim me Mjete Higjenike per Nevojat e Inspektoriatit Shëndetsor ,Farmaceutik dhe Sanitar"

Numri i Kontratës[1]: 206-24-9064-1-3-6/C711

Numri i Prokurimit: 206-24-9064-1-3-6

Operatori ekonomik: **" Teknika " SH.P.K.**

NUI: **810133116**

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

KONTRATË

Numri i kontratës [2]: **206-24-9064-1-3-6/C711**

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

" Teknika " SH.P.K., AGIM RAMADANI, PRISHTINE, (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me Mjete Higjenike per Nevojat e Inspektoriatit Shëndetsor ,Farmaceutik dhe Sanitar me numër identifikues: **206-24-9064-1-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizimi** nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	*Grupi*
1	**Furnizim me Mjete Higjenike per Nevojat e Inspektoriatit Shëndetsor ,Farmaceutik dhe Snitar**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim te kontratës dhe përfundon me 30 dit pas porosis

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë 30 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Ministria e Shëndetësisë

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP3 Detyra e Dërguar e Paguar

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **1,158.00** €; [Njëmijë e njëqindepesëdhjetetetë Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Nr	Emertimi i artikullit dhe pershkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi njesi me TVSH	Çmimi total me TVSH
Shampon					
1	Pastrues për pastrimin e sipërfaqeve nga druri - Reagues i menjëhershëm né sipërfaqet e drurit. Për tê vepruar né parket me dhe pa llak. Jo-gërryes. Me arome te mire. Furnizim në paketim re': 1500 ml	Copë	45	0.85	38.25
2	Shampon për ene-standard, me përmbajtje mesatarisht 20% adetiv, i mirë për lëkure. feri ose ekuivalent Njësia Paketimi 800 ml	Copë	20	0.75	15.00
3	Shampon per duar fresh, me aromë 500 ml aroma te ndryshme 5 lloje i kualitetit te lart	Copé	90	0.55	49.50

[2] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

[3] DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

4	Shampon për dysheme - standard per pllaka dhe qeramika. Shkalla Ph 10 - 12. Eco jo-toksike. Largues i gëlqeres. Pastron sipërfaqet pa gërvishte. Njësia/paketimi 1000 ml	Copë	90	0.60	54.00
Sprej					
1	Sprej për Xhama i specializuar, për pastrimin e xhamave, sprej me pompë 750 ml	Copë	35	0.75	26.25
Faculeta					
1	Letër per duar e trashe, e bardhe e gjere (dyfishi i letrës së tualetit) e kualitetit të lartë 3 shtresore 1/4 Kom leti	Kompleti	290	0.80	232.00
2	Lecke të kualitetit të lartë (1x3) microfiber origjinal	Kompleti	30	0.80	24.00
3	Lecka nga lekura e kualitetit të lartë për tharje	Copë	30	0.80	24.00
Leter tualeti					
1	Letër tualeti, dy shtresor e bardhe e kualitetit të lartë, (Komplet pako) 1/10	Kompleti	700	0.80	560.00
Aromatizues					
1	Aromatik pér Shole i léngshém	Copé	15	1.50	22.50
2	Freskues Aromatik të Ajrit, për hapsira të ndryshme për punë dhe jetë, Zyre, dhoma, toalete , salla une et'. 250 ml Airwik ose ekuivalent	Copë	10	2.50	25.00
3	Deodorant për urinar, vepron kunder eres - arome te kendshme, i treteshem ne ujë - leshon agjentet e pastrimit cdo here kur perdoret urinari dhe shmang bllokimin. Kontrollon shkallen e gelqers, shkallen e urines dhe depozitat e kalciumit.	Pako	10	1.00	10.00
Dezinfektues					
1	Dezinfektues per Toalete dhe Banjo, Gell 750 ml (Domestos) ose ekuivalent cilesi e larte	Copé	26	0.75	19.50
2	Thartie per pastrimin e njollave te vështira ne pllaka dhe qeramikën 1000 ml	Copê	9	0.90	8.10
Thase PVC					
1	Thasë PVC për mbeturina antibakterial 50 litërsh me ngjyre te zeze	set	20	0.50	10.00
2	Thasë PVC për mbeturina antibakterial 120 litërsh me ngjyre te zeze i përshtatshëm përvendosjen në shportë 110x70cm	set	15	0.70	10.50
Brusha pwr WC					
1	Brusha për WC me mbajtës Plastike per Shole	Copë	14	1.00	14.00
Xhokera					
1	Xhokera	Copë	7	2.20	15.40
				GRAND TOTAL:	**1,158.00**

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqipe[4]në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues		**Për Operatorin Ekonomik**	
Emri:	**Berat Marmullaku**	Emri:	Për: BLINDRË RAMA
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	AGJENT
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	8/10/2024	Data:	08.10.2024
Vula:		Vula:	SH. P. K. TEKNIKA PRISHTINË

[4] Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.